



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.4.2022 ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit në datat 29.03.2022 dhe 12.04.2022.

2. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare””. (*Komision për dhënie mendimi.*)

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Ferdinant Xhaferraj, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Vullnet Sinaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Ervin Saliçani, Isuf Çelaj dhe Kasëm Mahmutaj.

Mungojnë:

Toni Gogu, Paulin Sterkaj, Pranvera Resulaj, Flamur Noka, Lindita Metaliaj, Agron Çela, Luan Baçi dhe Enkelejd Alibeaj.

Të ftuar:

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë

Ilir Bejko – Drejtor i Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço - Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Pika e parë e rendit të ditës së mbledhjes së sotme është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit në datat 29.03.2022 dhe 12.04.2022.

Kush është dakord me procesverbalet?

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumente zyrtare””. Komisioni për Sigurinë Kombëtare e shqyrton këtë projektligj në cilësinë komisionit për dhënie mendimi.

Kemi të ftuar zonjën Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë, si dhe zotin Ilir Bejko, drejtor i Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Faleminderit që keni ardhur!

Fjala është për ju, zonja Pirdeni, për të bërë një prezantim në mënyrë të përmbledhur.

Adea Pirdeni – Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot ju paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare””, ose e quajtur ndryshe “Konventa nr.205/2009”.

Konventa përfaqëson të vetmin dhe të parin akt ndërkombëtar të dedikuar për aksesin në dokumente zyrtare, si një instrument thelbësor i pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje dhe si një shprehje e ushtrimit efektiv të demokracisë përfaqësuese.

Konventa nr.205/2009 e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, nënshkruar në Tromso në datën 18.6.2009, vendos standarde minimale të zbatueshme në shqyrtimin e kërkesave për akses në dokumente zyrtare, duke u lënë mundësi shteteve që të zgjerojnë mundësitë e këtij aksesit tej këtij minimumi përmes kuadrit të tyre ligjor të brendshëm.

Miratimi i këtij projekt-akti plotëson dhe zhvillon më tej kuadrin ligjor të brendshëm “Për të drejtën e informimit dhe aksesin në dokumentet zyrtare”, e drejtë që sanksionohet në nenin 23 të Kushtetutës dhe ligjin e vitit 2014 “Për të drejtën e informimit”.

Kjo konventë plotëson kuadrin ligjor të brendshëm, duke garantuar akses të plotë në dokumentet zyrtare, natyrisht në përputhje edhe me kufizimet e parashikuara në këtë konventë, të

cilat konsistojnë kryesisht në mbrojtjen e interesave të caktuara, si siguria kombëtare, mbrojtja e të dhënave personale, privatësia e kështu me radhë.

Nga pikëpamja procedurale, kjo konventë është miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1123, datë 30.12.2020 “Për miratimin në parim të Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumente zyrtare”, dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i përhershëm në misionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, ambasadori Dastid Koreshi, në datën datë 28.01.2022.

Natyrisht, i gjithë ky proces është zhvilluar në respektim të plotë të të gjithë kuadrit kushtetues dhe ligjor për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe integrimin e tyre në sistemin juridik të brendshëm. Ky projektligj ka kaluar përgjatë të gjithë procesit të konsultimit të projekt-akteve me të gjitha institucionet e linjës.

Projektligji përmban tre nene. Specifikisht, në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se, në përputhje me nenin 12, pika 1 e kësaj konvente, Republika e Shqipërisë cakton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si përfaqësues në këshillin e palëve, në cilësinë e institucionit përgjegjës për garantimin e zbatimit të konventës, bazuar në fushën institucionale të përgjegjësisë së këtij institucioni.

Së fundi, përmes këtij projektligji synohet të rritet efektiviteti i zbatimit të së drejtës për akses në dokumentet zyrtare, me qëllim nxitjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, nxitjen e integritetit në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe garantimin e mirëqeverisjes në tërësi.

Natyrisht, mbetemi të hapur për diskutime ose për çdo pyetje që do të çmohet me vend nga anëtarët e nderuar të këtij komisioni.

Faleminderit, kryetar!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Pirdeni!

Relator është zoti Denis Deliu. Ju lutem, lexojeni materialin në mënyrë të përmbledhur, sepse ne e kemi mbi tryezë!

Denis Deliu – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zëvendësministre,

I nderuar drejtor i ministrisë,

Si relator i projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare””, do të mundohem ta lexoj sa më shkurt relacionin pasi zëvendësministrja e sqaroi shumë mirë projektligjin.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin e brendshëm dhe të Drejtën Ndërkombëtare të Detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, konkretisht me nenin 121 të Kushtetutës, si dhe nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare e Shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji ka qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për të garantuar të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare, rritjen e transparencës së autoriteteve publike, si një tipar kyç i qeverisjes së hapur për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet me interes publik, të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare, si thelbësore për ushtrimin dhe realizimin e të drejtave themelore të njeriut.

Ndër përparësitë që sjell projektligji i propozuar, është garantimi i të drejtës së informimit nëpërmjet aksesit në dokumentet zyrtare, si dhe shërben si një ndihmë për publikun që të krijojë një opinion për gjendjen e shoqërisë. Kjo do të nxisë përgjegjshmërinë dhe efektshmërinë e autoriteteve publike.

Kjo konventë njihet si kufizime mbrojtjen e interesave të caktuara, si siguria kombëtare, privatësia, mbrojtja dhe marrëdhënia ndërkombëtare. Gjithashtu, aksesin në dokumentet zyrtare mund të kufizohet me qëllim që të sigurohet parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e aktiviteteve kriminale, që mund të çojë në shkatërrimin e provave. Po ashtu, e drejta e aksesit në dokumente mund të kufizohet për arsye të hetimeve disiplinore, inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet publike, privatësisë dhe interesave të tjera legjitime.

Projektligji përmban 3 nene, por në nenin 2 shprehet se Republika e Shqipërisë cakton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si përfaqësues në këshillin e palëve.

Konventa përbëhet nga 22 nene, në të cilat rregullohet e drejta e aksesit në dokumentet zyrtare si nga personat fizikë, ashtu edhe nga ata juridikë pa diskriminim, parashikon rastet kur kufizohet e drejta e aksesimit të dokumenteve, ruajtjen e anonimatit, orientimin e kërkuesit për tek autoriteti publik kompetent në rastet kur nuk e ka dokumentin zyrtar të kërkuar, si dhe marrjen e masave të nevojshme për të bërë publik dokumente zyrtare.

Projektligji është hartuar nga Mistria e Drejtësisë, si dhe i është nënshtruar një procesi konsultimi gjithëpërfshirës. Janë marrë mendime nga ministritë e linjës dhe Komisioneri i Mbrojtjes të të Dhënave Personale mbi nevojën reale për pranimin e kësaj konvente nga vendi ynë, përparësitë dhe problematikat që mund të lindin dhe nuk ka pasur ndonjë pengesë ligjore për fillimin e proceduarve. Në përputhje me ligjin 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, pas përfundimit të procedurave të ratifikimit të kësaj konvente, ajo do të ketë fuqinë e akteve normative, sipas nenit 116 të Kushtetutës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare.

Për sa lexova më sipër, kërkoj nga të gjithë kolegët, që kjo konventë të miratohet.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Deliu për relatimin!

Ka pyetje?

Zoti Salianji.

Ervin Salianji – Faleminderit!

Sipas Këshillit të Europës, hapja e arkivave e mund të luajë një rol të rëndësishëm në dhënien llogari nga ana e qeverive për veprimet dhe mosveprimet e tyre dhe në përballje me të kaluarën. Pra, kur flasim për përballje me të kaluarën, Shqipëria ka një problematikë që i rri pothuajse si çekan mbi kokë gjatë gjithë kohës, dhe gjatë gjithë diskutimeve në publik përdoret apo keqpërdoret në shumë raste, për të intimiduar persona të ndryshëm, në raste të caktuara persona me të shkuar të errët, që mund të jenë në krye të institucioneve. A mendoni që miratimi i kësaj konvente i hap rrugën edhe hapjes së dosjeve të ish -Sigurimit të Shtetit, që pengohen sot për shkak të këtij ligji? A ka ardhur nevoja që, edhe ligji që pengon hapjen e dosjeve, në zbatim të konventës që do të miratohet edhe me dakordësinë tonë, ta hapë rrugën për këtë?

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Salianji.

Zonja Pirdeni.

Adea Pirdeni – Faleminderit, i nderuar deputet!

Në fakt, edhe sikur e paraqitëm në parashtrësën e këtij projektakti, kjo konventë është hartuar që në krye të herës, në vitin 2009, por ka hyrë në fuqi në vitin 2020, për shkak se parashikohej shprehimisht se kjo konventë do të hynte në fuqi me ratifikimin e së paku 10 vendeve

nënshkruese, ratifikuese më pas, përbën një akt ndërkombëtar shumë të rëndësishëm në fushën e aksesit në dokumentet zyrtare.

Ligji në fuqi për të drejtën informimit për dokumentet zyrtare, pavarësisht faktit se kjo konventë ende nuk kishte hyrë asokohe, në momentin që është hartuar ai projektligj, ka marrë në konsideratë parimet dhe principet kryesore mbi bazën e të cilave bazohet edhe ligji ynë aktual. Në fakt, sikurse edhe në legjislacioni tonë të brendshëm kjo konventë parashikon specifikisht dhe rastet kur mund të kufizohet. Pra, parashikohet kufizimi i së drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare, specifikisht në nenin 3 të konventës, ku detajohen të gjitha rastet, kur shikohet me vend që shtetet mund të kufizojnë potencialisht aksesin në dokumente zyrtare. Këto kufizime, sikurse parashikon edhe neni 17 i Kushtetutës, do të duhet të parashikohen shprehimisht me ligj. Kjo do të thotë që në bazë të legjislacionit ekzistues mund të ketë kufizime në aksesin në dokumente. Sikurse edhe ju e dini, kryesisht kufizimet kanë të bëjnë me çështje të sigurisë publike, të sigurisë kombëtare dhe me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe për një sërë rastesh të tjera, që janë të specifikuar në pikën 1, geramat a, b, c dhe në vijim të kësaj konvente.

Kjo do të thotë që konventa nuk përbën një bazë kufizuese më tej se çfarë parashikon legjislacioni ynë shqiptar, por vendos një kuadër ndërkombëtar ku ne aderojmë, për të sanksionuar dhe për t'u garantuar qytetarëve shqiptarë dhe jo vetëm qytetarëve shqiptarë, por edhe shoqërisë civile, edhe medias akses në dokumentet zyrtare me të njëjtat standarde si në vendet e tjera, të cilat e kanë nënshkruar dhe e kanë ratifikuar këtë konventë.

Nasip Naço – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, duke qenë se s'ka më pyetje dhe diskutime, ky projektligj ka kaluar edhe në Komisionin e Ligjeve dhe ne jemi vetëm për dhënie mendimi, mendoj ta hedhim në votim. Kush është dakord në parim për projektligjin “Për ratifikimin e konventës të Këshillit të Europës” “Për aksesin në dokumentet zyrtare”? Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen të projektligjit “Për ratifikimin e konventës të Këshillit të Europës” “Për aksesin në dokumentet zyrtare”. Kush është dakord me nenin 1? Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për ratifikimin e konventës të Këshillit të Europës” “Për aksesin në dokumentet zyrtare”? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zonja Pirdeni!

Faleminderit, zoti Bejko!

Faleminderit, të nderuar kolegë për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!

MBYLLET MBLEDHJA